



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 306 Prot.

Vau Dejes me 18. 01 .2023

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funksonimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Naraç (të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Vau Dejes të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

**Projekt Vendim per “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 5800 m2, pjesë e pasurisë nr 7/12, Zk nr 2763, e llojit "Pa fryt", në fshatin Naraç, Bashkia Vau Dejës”.**

(Paraqitur nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Integritetit Sektori Aseteve.)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **14.02.2023 ora 10.00** fshati Naraç, Njësia Administrative Vau Dejes.

Gjithashtu ju ftojme të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al), facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Ardian ÇELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETIVE

### PROJEKT VENDIM

Nr 05.datë 13.01.2023

**Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 5800 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë nr 7/12, Zk nr 2763, e llojit “Pa fryt”, në fshatin Naraç, Bashkia Vau Dejës.**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1”(ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vërtëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr 1423 datë 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës”, në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54 dt 05.02.2014,”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

### VENDOSI

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 5800 m<sup>2</sup>, e llojit ranishte “Pa Fryt”, me afat deri 10 vjet, pjesë të pasurisë nr 7/12, Zk nr 2763, sipas plan rievimit bashkëlidhur, ndodhur në fshatin Naraç, Bashkia Vau Dejës.
2. Efektet: Jep efekte pozitive në komunitet, duke hapur vende te reja pune si dhe duke siguruar të ardhura për Bashkinë, të cilat kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera dysHEME vjetore e dhënies me qira të jetë e bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e Veëndimit të Këshillit të Ministrave nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me procedurat e konkurimit, shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe më pas me hapat e mëtejshëm procedurës, me të gjithë elementet përbërës të saj, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Kristian SHKRELI**



*Konceptoi: Armand Filipi*

*Miratoi: Ndoc Baqli*

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to Ndoc Baqli, written over the text "Miratoi: Ndoc Baqli".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETVEVE

**RELACION**

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISE SHTETËRORE E LLOJIT "PA FRYT" ME  
SIPËRFAQE PREJ 5800 M2, NË FSHATIN NARAÇ, BASHKIA VAU DEJËS

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimi dhe ruajtja e tokave dhe kategorive të tjera të resurseve si toka te pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara ne pronësi të saj, me qëllim dhënien në përdorim me anë të konkurimit, të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe per rrjedhoje rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave te paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetve publike bëhet nje përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore*", ndryshuar, bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj, me kontratë qiraje, duke zhvilluar procedurën përkatëse të konkurimit me të gjithë elementët përbërës të saj. Bazuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme ardhur nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, pasuria që propozohet të jepet në përdorim rezulton e llojit Ranishte, që futet në grupin e tokave cilësisht të dobëta, të cilat për efekt tarifimi cilësohen si "Toka pa fryt".

Bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018 "*Për zbatimin e VKM-së nr 54 datë 05.02.2014, Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, pasuria e llojit "Pa fryt", jepet me qira me anë të procedurës së konkurimit, me afat deri në 10 vjet..

Po sipas udhëzimit të mësipërm, vlera dysHEME e qirasë vjetore për fillimin e konkurimit sipas Udhëzimit nr 13, datë 18.04.2018, dhe VKM-së së mësipërme, për tokat e pafrytshme, është jo më e ulët se 27 000 leke/Ha në vit.

Sipërfaqja prej 5800 m2, që propozojmë të jepet me qira me anë të konkurimit është pjesë e sipërfaqes së përgjithshme prej 40 862 m2, të pasurisë nr 7/12, Zk nr 2763, ndodhur në fshatin Naraç, Bashkia Vau Dejës, e cila në kartelën e pasurisë së paluajtshme, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, rezulton pronësia Shtet, e llojit Ranishte "Pa fryt".

Pas miratimit në KB dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, vazhdohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe procedurën e mëtejshme me të gjithë elementët përbërës të saj deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Duke ju falenderuar.

#### Hartuesit e relacionit

Ndog Baqli



Armand Filipi



Ilda Prendi



**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Kristian SHKRELI**



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

POROSITES: AGIM GJOKA

DATE 12.10.2021

QELLIMI MARRJE ME QIRA

VENDNDODHJA

BASHKIA VAU DEJES

DVASHKIZVASHK SHKODER

ZONA KADASTRALE 2763

NUMRI I PASURISE 7/12-S1

INDEX HARTE K-34-76-(5-B)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE

SIP. PASURISE= 5800 m<sup>2</sup>

SIPERFAQE E GJURMES NDERTIMIT= \_\_\_ m<sup>2</sup>

NUMRI I KATEVE \_\_\_


NUMRI I PEMEVE \_\_\_

X, Y 470400.0

470600.0

X, Y

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:2500

470400.0 470600.0

X, Y 470400.0

X, Y

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERENDIM					

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: HAMID ÇULIQ

LICENCA: NR. T-0675/2 DATE 10.04.2018

KOMPANIA:

NIPT:

NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER VASHK

SPECIALISTI:

DVASHK:

NENSHKRIMI:

KONFIRMO!

PERGJEGJES/DREJTORI:

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: G, T

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI I KUFIRIT: P, HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kuftaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

KY PLAN RILEVIMI REALIZOHET ME KERKESEN E POSEDUESIT SIPAS MATJEVE FAKTIKE NE TERREN TE KONTURIT TE PRONES, PER EFEKT MARRJE ME QIRA PRANE INSTITUCIONEVE PERKATESE.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARE

EMRI:

NENSHKRIMI:

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kuftaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;